

Rast studimi

MIGRIMI I TË RINJVE NGA KOSOVA

Studim i gjeneratës së vitit 2020



Titulli i hulumtimit:

Migrimi i të rinjve nga Kosova – Studim i gjeneratës së vitit 2020

Botuesi:

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS
Adresa: Nika Prena Vila 13, 10000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni: +383 38 542 157
Email: info@kfos.org
Ueb faqja: <https://www.kfos.org/>

Për botuesin:

Autor: Dushica Joviçiq (Dušica Jovičić)
Bashkëautor: Miodrag Marinković (Miodrag Marinković)
Bashkëpunëtor i ri hulumtues: Maksim Aksiq (Maksim Aksić)
Lektorja: Aleksandra Joviçiq-Gjinović (Aleksandra Jovičić-Dinović)
Përkthimi në gjuhën shqipe: Nora Bezera
Përkthimi në gjuhën angleze: Kruna Petriq (Kruna Petrić)
Dizajni: CAP Solutions

Tirazhi: 150 kopje**Viti i botimit: Prill, 2023**

Mohim përgjegjësie: ThKy publikim u bë i mundur falë mbështetjes së Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), në bashkëpunim me OJQ CASA. Vetëm autorët janë përgjegjës për pikëpamjet e shprehura këtu, të cilat nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it. Gjithashtu duhet theksuar se studimi është pjesë e një nisme që ka marrë bashkëfinancim nga Ambasada Britanike në Kosovë.





Përmbajtja

• Hyrje _____	3
• Metodologjia e hulumtimit _____	4
• Konteksti socio-politik _____	5
• Përmbledhje _____	6
• Arsimi _____	7
• Ekonomia _____	10
• Politika _____	12
• Familja dhe miqtë _____	14
• Përfundimi _____	16

Hyrje

Ky hulumtim i rastit paraqet rezultatin e analizës së thellë të problemit të migrimit të të rinjve, i cili konsiderohet problem i rëndësishëm brenda komunitetit serb në Kosovë. Migrimet e herëpashershme të të rinjve ekzistojnë brenda çdo gjenerate, mirëpo në këtë rast situata është më ndryshme, madje është paralajmëruese, sepse nga veriu i Kosovës kanë zgjedhur të largohen 60% e nxënësve të Gjimnazit në Mitrovicën e Veriut. Në gjeneratën e vitit 2020, nga gjithsej 40 studentë (21 në drejtim matematiko-natyror, 19 në drejtim shoqëror-gjuhësor), 25 prej tyre u larguan nga Kosova (17 nga drejtimi matematiko-natyror, 8 nga drejtimi shoqëroro-gjuhësor). Përmasat e këtij fenomeni janë edhe më treguese në rastin e klasës 4/1, në drejtimin matematiko-natyror të këtij brezi. Pikërisht ky rast ka shërbyer si nxitje për realizimin e këtij hulumtimi. Në këtë klasë, nga gjithsej 21 nxënës, 17 u larguan nga Kosova. Këto shifra, së bashku me të kuptuarit e pasojave negative të migrimit, e paraqesin motivimin fillestar për ta prezantuar rastin e gjeneratës së vitit 2020 në këtë studim rasti.

Ndonëse mundësitë për të marrë një arsimim më cilësor në Serbi ishin shtytësi fillestar i këtij migrimi, janë zbuluar edhe shumë faktorë të tjerë që kanë pasur një efekt kumulativ në largimin e popullatës së re nga veriu i Kosovës. Një sërë faktorësh që ndikojnë në uljen e mundësive për pavarësi ekonomike të të rinjve (punësimi nëpërmjet nepotizmit, korrupsioni, tregu armiqësor për të rinjtë), politika ((pa)siguria, situata politikisht e paqëndrueshme), si dhe faktorë sociologjike (cilësia e arsimit, jeta e përditshme) kanë ndikuar në vendimin e tyre për t'u larguar. Duke i identifikuar këta faktorë ndikues, ne përfituam njohuri për ndërlidhimin e modeleve të migrimit dhe pasojat e tyre për komunitetin serb në Kosovë. Vështrimi i përfituar në këtë mënyrë, u thellua në të kuptuarit e hollësishëm të faktorëve që ndikojnë në vendimet për migrimin e të rinjve dhe kështu u zbuluan problemet kryesore me të cilat përballen të rinjtë. Hulumtimi hedh dritë edhe mbi ndikimin negativ të këtij migrimi në komunitetin serb, nëpërmjet

dukurive si largimi i trurit (barin drain) dhe efekti i topave të borës¹.

Veçanti e këtij hulumtimi është fakti se të rinjve të gjeneratës së vitit 2020 iu dha mundësia që të shprehin qëndrimet, opinio-net dhe vlerësimet e tyre nëpërmjet zhvillimit të intervistave. Kjo gjë ndikoi në zhvillimin e këtij studimi të rastit në një dëshmi autentike dhe organike të të rinjve për problemet të cilat ndikojnë që ata të largohen nga veriu i Kosovës, përkundër ndjenjave pozitive që i lidhin me atë hapësirë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të kontribuojë në debatin aktual mbi migrimin e popullatës së re dhe ndikimin e tij në mbijetesën dhe potencialin zhvillimor të komunitetit serb në Kosovë. Në kapitujt në vijim do të mund të njiheni më gjerësisht me shkaqet kryesore dhe ato dytësore të migrimit të popullatës së re nga veriu i Kosovës dhe për situatën socio-ekonomike-politike që është katalizator i këtyre migrimeve. Të gjitha shkaqet e përmendura - sociale, ekonomike, politike dhe personale duhet të shihen si pjesë e një tërësie, pjesë që janë të ndërlidhura mes vete, andaj duhet të shihen së bashku për ta kuptuar në mënyrë adekuate procesin e migrimit të të rinjve nga veriu i Kosovës.

¹ Një frazë e përdorur për të treguar trendin e përshpejtimit/ritjes së shtrirjes së një fenomeni. Në këtë kontekst, autorët ia atribuojnë trendit të pandalshëm të migrimit të të rinjve.

Metodologjia e hulumtimit

Të dhënat bazë për studimin:

- Mënyra e hulumtimit: metoda shpjeguese e studimit të rastit
- Instrumenti i kërkimit: intervista individuale e thelluar, analiza e përmbajtjes
- Burimet e të dhënave për rastin: intervista, publikime, medie
- Periudha e hulumtimit: 16 janar - 7 prill 2023.
- Vendi i hulumtimit: Mitrovica e Veriut, Beogradi, Novi Sadi
- Numri i përgjithshëm i të anketuarve: 12
- Numri i të intervistuarve nga gjenerata 2020: 8
- Numri i të intervistuarve që kanë mbetur në Kosovë: 1
- Numri i prindërve të intervistuar: 3

Gjatë përpilimit të këtij hulumtimi të rastit, është përdorur një kombinim i dy metodave cilësore për mbledhjen e të dhënave: intervista e thelluar individuale dhe analiza e përmbajtjes së publikimeve përkatëse për migrimin e të rinjve. Me qëllim të mbledhjes së të dhënave, janë krijuar tre pyetësorë të veçantë: një për gjeneratën 2020, një për prindërit, fëmijët e të cilëve janë larguar nga Kosova, si dhe një për të rinjtë që kanë mbetur në Kosovë pas diplomimit. Intervistat janë realizuar në periudhën nga 27 janari deri më 1 mars, intervista të drejtpërdrejta dhe nëpërmjet platformës online, që do të thotë se realizimi i tyre është përshtatur me kushtet e dhëna. Hulumtimi sekondar (Desk research) e nënkupton analizën e literaturës përkatëse, e cila merret me problemin e migrimit të të rinjve.

Analiza e të dhënave ka përdorur një sistem kodimi që i njeh shkaqet më të rëndësishme të largimit të të rinjve, kur bëhet fjalë për të dhënat e marra nëpërmjet intervistave dhe analizës e sintezës së materialit teorik dhe empirik të disponueshëm për migrimin e të rinjve. Kodet, që në këtë rast përbëjnë faktorët socialë, politikë, ekonomikë dhe personalë, paraqesin njësi analitike që kanë

karakteristika të qarta dalluese, në bazë të të cilave të dhënat e marra nëpërmjet intervistave u ndanë në kategori. Thelbi i këtij procesi është që deklaratat të reduktohen dhe të përkthehen në kategori, në bazë të të cilave më pas është kryer analiza. Kjo analizë paraqet dokumentin bazë, i cili më pas është përmirësuar me të dhëna të marra nga hulumtimi sekondar (desk research), i formësuar në një studim rasti.

Konteksti socio-politik

Natyrë e lëvizjeve migruese në një komunitet përcaktohet nga konteksti social, gjegjësisht rrethanat sociologjike, politike, ekonomike, kulturore dhe rrethana të tjera. Në këtë mënyrë mund të interpretohen edhe migrimet nga Kosova. Në natyrën e tyre, ato pasqyrojnë situatën aktuale në Kosovë, e cila është shënuar tërësisht me luftën në Kosovë dhe bombardimet e vitit 1999, si dhe konfliktin etnik si katalizator i asaj lufte. Në raport me pasojat që kanë pasur këto ngjarje në situatën aktuale në Kosovë, ato janë përcaktues thelbësorë i saj, kështu që jeta e përditshme ende vështrohet nga prizmi i konfliktit etnik.

Duke i analizuar të dhënat e ndryshme në dispozicion², është vlerësuar se pas bombardimeve të NATO-s të RF të Jugosllavisë në vitin 1999, rreth 200 mijë serbë u larguan nga Kosova, ndërsa në vitin 2004 - gjatë dhe pas pogromit të marsit, u larguan rreth tre mijë serbë. Ato migrime masive të detyruara të popullsisë ishin të motivuara nga pasojat e luftës, si dhe nga frika për ekzistencën e rrezikuar të tyre. Pas këtyre fazave, pasoi një periudhë stabilizimi që zgjati disa vjet, dhe në të cilën nuk pati largime masive të serbëve nga Kosova.

Në dhjetë vjetet e fundit, pas ndryshimit të pushtetit në Serbi në vitin 2012, ka pasur një ndryshim të dukshëm në politikën e Beogradit ndaj Kosovës. Karakteristikë kryesore e qasjes së re ishte politika e koncesioneve ndaj Prishtinës dhe Bashkësisë Ndërkombëtare: shfuqizimi i institucioneve që punonin sipas sistemit administrativo-juridik të Republikës së Serbisë dhe zgjerimi i juridiksionit juridik të Prishtinës në veri të Kosovës. Në të njëjtën kohë, nuk ka pasur reciprocitet në koncesionet në favor të komunitetit serb, në lidhje me themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe, i cili është dashur të formohet sipas parimeve të dakorduara në Marrëveshjen e Brukselit. Ajo solli me vete të gjitha efektet negative të konfliktit të zgjatur

etnik, duke përfshirë pasigurinë dhe një mjedis të papërshtatshëm për zhvillim ekonomik. Përveç kësaj, krijimi i një elite të re politike, përkatësisht Listës Serbe, e cila e monopolizoi hapësirën politike, krijoi një deficit të konsiderueshëm demokratik në komunitetin serb në Kosovë. Efekti kumulativ i këtyre faktorëve është përshpejtimi i migrimit të heshtur, largimi sporadik, por i vazhdueshëm i popullsisë, në radhë të parë i të rinjve. Rasti i gjeneratës së vitit 2020 të gjimnazit në Mitrovicën e Veriut, është një tregues shumë i rëndësishëm i këtij fenomeni, si dhe një tregues i efektit të deficitit shoqëror në trendet demografike.

Migrimet masive zakonisht shkaktohen nga trazira të mëdha, domethënë nga ngjarje që kanë një potencial të madh shkatërrues, siç janë luftërat dhe fatkeqësitë natyrore. Megjithatë, migrimet e heshtura janë të një natyre tjetër: ato janë më të vështira për t'u zbuluar, ndërsa faktorët që ndikojnë në to janë më kompleksë. Më shumë se dy dekada pas luftës dhe 15 vjet pas shpalljes së pavarësisë nga pushteti në Prishtinë, gjendja në veri të Kosovës është jashtëzakonisht dekurajuese për të rinjtë. Një numër i madh hulumtimesh kanë treguar se pakënaqësitë e tyre janë rrjedhojë e disa faktorëve: shkalla e lartë e papunësisë, paqëndrueshmëria e përgjithshme ekonomike, niveli i (pa)sigurisë, gjendja politike, si dhe gjendja jo e mirë e sistemit arsimor. E vështruar në këtë mënyrë, çështja e migrimit kthehet në një çështje politike. Nëse e kemi pranuar idenë e përmendur më parë, se natyra e migrimit përcaktohet nga konteksti shoqëror, ndryshimet thelbësore në veri të Kosovës do të mund të kishin një efekt volte-face (kthesë, ndryshim qëndrimi) në trendin e migrimit të popullatës së re, domethënë ato mund të kthenin mbrapsht tendencat ekzistuese. Megjithatë, mundësitë për ndryshime nuk janë objekt i këtij studimi. Ky hulumtim fokusohet në modelet e migrimit të popullatës së re nga Kosova.

² Më hollësisht për migrimet e detyruara të serbëve nga Kosova: <https://www.amnesty.org/fr/wp-content/uploads/2021/07/eur700042007en.pdf>
<https://www.unhcr.org/3ba0bbeb4.pdf>

Përmbledhje

- 1. Gjendja e arsimit** në veri të Kosovës është arsyeja kryesore që gjenerata e vitit 2020 vendosi të largohet nga Kosova pas përfundimit të shkollës së mesme. Gjendjen e arsimit në nivelin akademik në Universitetin e Mitrovicës, këta të rinj e vlerësojnë jocilësore, të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për nevojat e tregut të punës.
- 2.** Faktorët politikë që kanë ndikuar në largimin e të rinjve janë **jostabiliteti politik dhe konflikti etnik. Paqëndrueshmërinë politike** në vend të rinjtë e përshkruajnë nëpërmjet eufemizmave të tilla si tensione e probleme, por nuk tregojnë shumë interes për ngjarjet politike në komunitetin e tyre. **Konflikti etnik** mbetet një çështje thelbësore për të rinjtë e gjeneratës 2020, të cilët na tregojnë se distanca etnike është shumë e theksuar dhe proceset e pajtimit të ndërmarra në 20 vjetët e fundit, nuk e kanë pasur efektin e dëshiruar.
- 3.** Mungesa e mundësive për afirmim ekonomik të të rinjve u identifikua gjithashtu si njëri nga faktorët kryesor që ndikoi në vendimin për largimin e tyre. Ndër faktorët ekonomikë që kanë ndikuar në largimin e të rinjve janë: tregu armiqësor për të rinjtë dhe krimi ekonomik. **Tregu i punës** në veri të Kosovës, sipas mendimit të të rinjve të gjeneratës të vitit 2020, nuk ofron një punë me të cilën mund të planifikojnë të merren pas përfundimit të studimeve. Për më tepër, sipas tyre, tregu i punës është armiqësor ndaj tyre. Përveç kësaj, **korrupsioni** dhe **nepotizmi** përfaqësojnë pengesa të pakapërcyeshme për ta, gjersa flasin për perspektivën e punësimit të të rinjve në veri.
- 4.** Faktorët personalë që ndikuan në largimin e të rinjve janë **mbështetja e prindërve dhe miqve** në marrjen e vendimit për t'u larguar. **Prindërit** i mbështesin fëmijët e tyre për t'u larguar, duke besuar se në këtë mënyrë po i mbrojnë dhe i ndihmojnë të jenë të suksesshëm më vonë në fushat me të cilat planifikojnë të merren. Mbështetja e miqve është po aq e rëndësishme sa që është në rritje të efektit të topave të borës, që është një fenomen specifik në flukset migruese të të rinjve nga veriu i Kosovës.
- 5. Asnjë pjesëtar i gjeneratës 2020 nuk planifikon të kthehet në Kosovë pas studimeve³.**

³ Asnjë i anketuar nuk do të kthehej pa kushte. Dy do të ktheheshin me kusht që të përmirësohen kushtet e tregut të punës, edhe pse ata nuk mendojnë se kjo do të ndodhë. Pjesa tjetër nuk e konsideron mundësinë e kthimit.

Arsimi

- PJESËTARËT E GJENERATËS 2020 E CEKIN NEVOJËN PËR ARSIMIM MË TË MIRË SI ARSYE KRYESORE PËR LARGIMIN NGA KOSOVA
- ATA E SHIKOJNË ARSIMIMIN SI NJË BURIM TË RËNDËSISHËM QË DO T'U MUNDËSOJË PUNË TË MIRË DHE NJË TË ARDHME MË TË MIRË
- FAKULTETET QË I REGJISTRUAN: FET, FSHO, FSHP, FAKULTETI JURIDIK

Arsimi i lartë në gjuhën serbe në Kosovë zhvillohet në kuadër të Universitetit të Mitrovicës, i cili funksionon në përputhje me sistemin arsimor serb. Universiteti ofron mbi njëqind programe studimi. Në vitin 2021 aty kanë studiuar 9 mijë studentë. Ky numër u zvogëluar për 25 studentë, për shkak se 25 nxënës të gjimnazit në Mitrovicën e Veriut, vendosën ta vazhdojnë shkollimin në Serbi.

Largimi nga Kosova pas përfundimit të shkollës së mesme mund të interpretohet si një vendim pragmatik i të rinjve të orientuar drejt qëllimeve: qëllimi i tyre është t'i ofrojnë vetes një pozicion më të mirë në tregun e punës dhe rrugën drejt këtij qëllimi e shohin përmes arsimimit cilësor.

Për t'i kuptuar më mirë motivet e tyre, është e rëndësishme të theksohet se ata bëjnë një dallim cilësor ndërmjet cilësisë (dhe vënies në përdorim) së njohurive që u ofrohen atyre në Universitetin e Mitrovicës në krahasim me universitetet në Serbi. Ky dallim detektohet në tri nivele: dallimi në cilësinë e programeve të studimit dhe në mundësitë për praktikë; dallimi në ofertën e programeve të studimit, të cilat, sipas tyre, janë më gjithëpërfshirëse dhe më të larmishme në universitetet në Serbi, gjë që bëri që ata të kenë më shumë mundësi gjatë përzgjedhjes së fakultetit; si dhe dallimi sa i përket reputacionit të atyre institucioneve.

Ata vlerësojnë se cilësia e studimeve në Universitetin e Mitrovicës nuk është në nivelin e duhur. Ky vlerësim bazohet në vlerësime subjektive, në përvoja të drejtpërdrejta, por edhe në paragjykimet që lidhen me punën e Universitetit. Këto paragjykime formohen

edhe në bazë të ngjarjeve të vërteta, siç ishte rasti me aferën në Fakultetin e Mjekësisë në vitin 2015, kur u publikua lajmi për keqpërdorimin e detyrës së dekanit⁴, i cili më pas u zgjodh rektor i Universitetit.⁵ Ngjarje të tilla, si dhe historia e korrupsionit e përhapur gjërësisht, ndikojnë drejtpërdrejt te të rinjtë, i dekurajojnë ata që të studiojnë në Kosovë dhe i motivojnë që të largohen. Në qoftë se gjenerata e vitit 2020 e ka formuar qëndrimin e saj sa i përket cilësisë së arsimit në Kosovë për shkak se ishte e ekspozuar ndaj narrativave të tilla, hulumtimet e bëra për këtë çështje, vetëm sa i konfirmojnë dyshimet e tyre. Ato dëshmojnë se çdo i dhjeti person ose e ka paguar provimin ose e ka njohur dikë që e ka bërë këtë gjë, dhe në fund e ka vlerësuar nivelin e cilësisë së arsimit në Kosovë me notën mesatare të mirë (3, 5).⁶ Përveç kësaj, Universiteti i Mitrovicës nuk renditet as në listën e Shangait dhe as në listën e Times Higher Education, të cilat konsiderohen si listat më prestigjioze botërore të renditjes së universiteteve⁷, gjë që pasqyron cilësinë e këtij institucioni.

Studenti 1, 21:

Mendoj se Universiteti atje poshtë nuk ka potencial të mjaftueshëm, as aftësi për të më ofruar njohuritë dhe arsimimin që do të doja...

Studenti 2, 21:

Synimi im ishte, me respektin e plotë për të gjithë, të avancoja njohuritë e mia në nivelin më të lartë të mundshëm, dhe kjo ishte e mundur padyshim vetëm në Beograd, sepse atje është me të vërtetë fakulteti më i mirë.

⁴ <https://kossev.info/rade-grbic-ekskluzivno-o-aferi-koja-trese-medicinski-u-kosovskoj-mitrovici-moja-strana-price/>
<https://www.vesti.rs/Kosovo/Presedan-na-Medicinskomp-fakultetu-u-Kosovskoj-Mitrovici-Kao-u-Nusicevim-komedija-ma-3.html>

⁵ <http://www.nspm.rs/hronika/grupa-profesora-univerziteta-u-pristini-kosovska-mitrovica-postavila-radeta-grbica-za-rektora-univerziteta.html?alphabet=I>

⁶ <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/01/Kvalitet-obrazovanja-na-severu-Kosova.pdf>

⁷ <https://www.shanghairanking.com/rankings/arwu/2022>

https://www.timeshighereducation.com/world-university-rankings/2023/world-ranking#/page/0/length/25/locations/SRB/sort_by/rank/sort_order/asc/cols/stats

E vështruar në këtë mënyrë, cilësia e arsimit të lartë në insitucionet në veriun e Kosovës, lidhet me faktorë sociologjikë dhe politikë. Arsimi në Kosovë shihet si *shtyllë e mbijetesës së popullit dhe inteligjencës në Kosovë e Metohi*,⁸ duke e theksuar funksionin politik, neglizhohet ai më i rëndësishmi: ai arsimor. Krijohet përshtypja se politizimi i arsimit në Kosovë po ndodh pikërisht në kurriz të cilësisë së arsimit që u ofrohet të rinjve; duke i trajtuar postet në Universitet si plaçkë partiake, me punësim sipas linjave partiake, madje edhe duke ia zënë frymën *potencialit rebel të studentëve* nëpërmjet kontrollit të trupave studentore. Të gjitha këto forma të manifestuara të ndikimit politik në sistemin arsimor, kanë një ndikim vendimtar në perceptimet e të rinjve, të cilat janë të një rëndësie vendimtare për orientimin që të studiojnë në disa qendra të tjera arsimore. Perceptimi në lidhje me arsimin është një çështje relative, dhe mospërputhja midis qëndrimeve të të rinjve që shkuan për të studiuar në Beograd dhe atyre që qëndruan, është e madhe. Të rinjtë që studiojnë në Universitetin e Mitrovicës janë të kënaqur me cilësinë e programeve të ofruara dhe mundësitë e punës që iu ofrohen atyre pas përfundimit të studimeve.

Ky boshllëk në qëndrimet rreth cilësisë së arsimit të ofruar në Universitetin e Mitrovicës tregon për nivelin e tretë të dallimit të universitetit, e kjo gjë është prestigji. Universiteti i Beogradit është një institucion me traditë më shumë se dy shekujlore dhe me reputacion në përputhje me traditën e institucionit më të vjetër të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Është renditur në listën e Shangait, në renditjen e Qendrës së Renditjes së Fakulteteve, Times Higher Education dhe në renditjen brenda Serbisë, gjendet në vendin e parë. Duke pasur parasysh këtë, për të rinjtë, Universiteti i Mitrovicës është një opsion më pak i dëshiruar për studime.

“

Studenti 3, 21:

(rreth FET-it në Beograd): Ai e ka atë reputacion; është e njohur në botë, thjesht, kjo është ajo që më tërhoqi më shumë...

”

Çështjen në lidhje me prestigjin e mbështet edhe fakti se ka raste të të rinjve që janë regjistruar në fakultete në Serbi, edhe pse të njëjtat programe studimore i kanë pasur në dispozicion edhe në Kosovë, siç janë drejtimet e Fakultetit të Teknologjisë apo ai Fakultetit Juridik. Andaj, prestigji i institucionit që do të ndjekin është ndër të tjera, një faktor shumë i rëndësishëm për të rinjtë gjatë përzgjedhjes. Megjithatë, gjersa i vlerësojnë institucionet si të tilla, ata nuk e konsiderojnë arsimin/dijen si vlerë në vetvete. Ata vlerësojnë vlerën e përdorimit të njohurive, kështu që ajo përfaqëson në thelb një metodë për të arritur një punë të mirë dhe të qëndrueshme. Ky lloj instrumentalizimi i njohurive, nëse nga dukuria, do të bëhej trend, do të mund të çonte në humbjen e interesit të të rinjve për shkencat shoqërore dhe humane. Ato diploma, në kontekstin aktual shoqëror të glorifikimit të njohurive të dobishme shoqërore, po bëhen gjithnjë e më pak të dobishme. Megjithatë, përqindja e studentëve që regjistrohen në shkencat natyrore është ende më e ulët se e atyre që regjistrohen në shkencat sociale, kështu që kjo nuk paraqet një kërcënim të menjëhershëm.⁹ Mirëpo, në sistemin arsimor serb, profesioni i mësuesit të sociologjisë dhe psikologjisë tashmë është deficitar, ashtu siç është edhe profesioni e mësuesit të matematikës dhe informatikës, ngaqë sot, të rinjtë që studiojnë shkencat natyrore, gjithnjë e më shumë, po zgjedhin të punojnë në sektorin privat. Të njëjtën tendencë e kanë shfaqur edhe të rinjtë nga Kosova, të cilët nuk planifikojnë të punojnë në sektorin shtetëror, por në atë privat.¹⁰ Ata konsiderojnë se studimet në Beograd janë një parathënie e shkëlqyer për këtë qëllim.

Nga të gjitha çështjet e cekura më sipër, mund të konstatohet se funksioni i institucioneve, siç janë institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, janë një nga parakushtet për mbijetesën e serbëve. Numri i studentëve në Universitetin e Mitrovicës, i ulur për numrin e të rinjve që shkojnë për të studiuar në Serbi çdo vit, plotësohet me studentë që vijnë nga Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia, kështu që vetë Universiteti nuk është i rrezikuar nga humbje të mëdha. Megjithatë, nuk ka dyshim se ky lloj i *ikjes së trurit*,

⁸ <https://www.kim.gov.rs/v4301.php>

⁹ [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=File:Distribution_of_tertiary_education_graduat_es_by_broad_field_of_education_2017_\(%25\)_ET19.png#filelinks](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=File:Distribution_of_tertiary_education_graduat_es_by_broad_field_of_education_2017_(%25)_ET19.png#filelinks)
<https://data.stat.gov.rs/Home/Result/104020402?languageCode=sr-Latn>

¹⁰ <https://insajder.net teme/secerov-dekan-geografskog-fakulteta-u-markeru-plate-nastavnika-u-svetu-20-do-30-o-dsto-lznad-prosecnih-u-srbiji-nize-od-proseka-video>

veçanërisht nëse është i përhershëm, mund të ketë pasoja të paparashikueshme për komunitetin e gjerë, por edhe për Universitetin. Kur nxënësit më të suksesshëm të shkollës së mesme më të suksesshme në Kosovë¹¹ shkojnë në numër të madh në Serbi për të studiuar, duke planifikuar të gjejnë një vend pune atje, do të kemi një ndikim të shumëfishtë shkatërrues ndaj të gjithë komunitetit serb, në kuptimin e humbjes së pakthyeshme të burimeve të rëndësishme njerëzore dhe të potencialit.

¹¹ Ky vlerësim duhet të merret me rezervë, sepse nuk bazohet në të dhëna objektive për cilësinë e shkollave të mesme në Kosovë (nuk ka pikë referimi objektive për radhitjen e shkollave të mesme në Kosovë). Ajo tashmë mbështetet në supozimin e një cilësie dhe gjerësie më të lartë të arsimit në gjimnaze, krahasuar me shkollat e mesme profesionale. Autorja beson gjithashtu se kur studentë më pak të suksesshëm hyjnë në institucionet e arsimit të lartë, si rregull, kriteret ulen për t'iu përshtatur aftësive të tyre, pra për t'iu mundësuar diplomimin. Kjo çon në prodhimin e hipertrofizuar të diplomave, vlera e përdorimit të të cilave ulet dhe në degradimin e institucioneve arsimore si të tilla.

Ekonomia

- PËRVEÇ ARSIMIMIT, SITUATA EKONOMIKE NË KOSOVË ËSHTË ARSYEJA MË E RËNDËSISHME PSE GJENERATA E VITIT 2020 POL LARGOHET NË SERBI
- FAKTORËT EKONOMIKË QË NDIKUAN NË VENDIMIN E TYRE PËR LARGIM JANË KRIMI EKONOMIK DHE TREGU I PUNËS QË ËSHTË ARMIQËSOR NDAJ TYRE

Nëse pranojmë si fakt që të rinjtë e gjeneratës së vitit 2020 e vlerësojnë arsimin si një instrument për të përmirësuar pozicionin e tyre në tregun e punës, mund të konkludojmë dy gjëra. Arsimi është faktori kryesor për shkak të të cilit të rinjtë largohen¹², por për nga natyra e tij është i pandashëm nga faktori ekonomikë. Nëse arsimimi shihet si një spiritus agens, ku qëllimi përfundimtar është - gjetja e një pune, çështja e arsimimit dhe çështja e punës duhet të shihen si të ndërlydhura.

Ashtu siç vlerësuan se arsimi më cilësor është në universitetet në Serbi, të rinjtë serbë gjithashtu vlerësuan se aty gjenden edhe mundësitë më të mira të punës. Arsimi u mundëson atyre që, në një kuptim më të gjerë, ta planifikojnë të ardhmen, dhe në një kuptim më të ngushtë, të pozicionohen më mirë në tregun e punës. Duke u pozicionuar mirë në tregun e punës, ata i shmangen papunësisë, të cilën e konsiderojnë si një nga problemet e rëndësishme me të cilat përballet të rinjtë në Kosovë.¹³ Shkalla e lartë e papunësisë së të rinjve, e kombinuar me pagat e ulëta në ato raste kur arrihet një vend pune, në periudhën kur kostoja e jetesës po rritet, nuk u ofron të rinjve në Kosovë një perspektivë tërheqëse.

Të rinjtë nga gjenerata e vitit 2020 e marrin shumë seriozisht planifikimin e së ardhmes së tyre. Prandaj, ata zgjedhin fakultete prestigjioze me programet më premtuese të studimit dhe, shpesh programe që kanë të bëjnë me teknologji të reja, që lidhen me profesionet që janë deficitare, duke shprehur se në këtë mënyrë do të jetë më lehtë për të gjetur një punë pas përfundimit të studimeve. Ata besojnë se Kosova nuk ka kapacitet për t'i përmbushur nevojat e tyre: numri i kompanive të TI-së është i papërfillshëm, tregu i punës është armiqësor

ndaj këtyre të rinjve, sektori shtetëror e dominon sektorin privat dhe praktikat e punësimit të bazuara në besnikërinë partiake e jo në kompetencë, janë gjerësisht të përhapura. Duke e pasur parasysh këtë fakt, largimi nga Kosova ishte i domosdoshëm, si një zgjedhje racionale për shumë të rinj.

Edhe pse potenciali zhvillimor i sektorit të TI-së¹⁴ është i njohur në Kosovë, situata është krejt ndryshe në komunat e veriut. Numri i kompanive të TI-së është i papërfillshëm në atë masë sa, edhe të rinjtë që duan të angazhohen në këto punë, nuk kanë dëgjuar asnjëherë për to dhe as nuk besojnë se Veriu mund të hapet ndaj këtij lloji inovacioneve. Shkaqet e këtyre problemeve, ndër të tjera, i gjetën në natyrën e mjedisit të ngushtë, në të cilin sektori privat është i pazhvilluar, i dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që nuk janë të prira për ta digjitalizuar biznesin e tyre. Veriu i mbyllur dhe tradicional i Kosovës, nuk ka kapacitet ekonomik për t'i përmbushur nevojat e tyre: ata mendojnë se nuk ka vend për inovacione, madje as edhe në sektorë fitimprurës si hoteleria. Në rrethana të tilla, të rinjtë ndihen të bllokuar dhe natyrshëm gravitojnë drejt mjediseve që mund t'ua ofrojnë atë që u nevojitet: ata gravitojnë drejt Beogradit dhe Novi Sadit.

Studenti 4, 21:



Në qytetet e mëdha ka kompani të TI-së ku mund të gjesësh punësim të mirë, ka më shumë mundësi punësimi... dhe unë nuk di gjithmonë të prezantoj veten në mënyrën më të mirë, kështu që kur ka më shumë mundësi, e kam më të lehtë t'i kap... Dhe të rinjtë ngecin aty poshtë, kanë më pak mundësi për punë dhe avancim.



¹² Këtë qëndrim e shprehën të gjithë të rinjtë që u intervistuan.

¹³ Të dhëna të sakta statistikore për papunësinë e të rinjve në Kosovë nuk ekzistojnë, prandaj të dhënat nga vendet e krahasueshme përdoren për të ilustruar; për shembull. Në vitin 2020, shkalla e papunësisë për të rinjtë nën moshën 24 vjeç ishte 26.6% në Serbi, 36.0% në Mal të Zi dhe 35.7% në Maqedoninë e Veriut. Në dispozicion në:

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/tepsr_wc170/default/table?lang=en

¹⁴ <https://balkans.aljazeera.net/videos/2022/5/4/it-sektor-razvojna-sansa-za-mlade-na-kosovu>

Kulmi i pakënaqësisë së të rinjve me situatën ekonomike shihet në mënyrë se si ata e shohin tregun e punës në veri të Kosovës: e shohin atë të kufizuar dhe nën dominimin e Republikës së Serbisë, si punëdhënësin kryesor. Vlerësimi i tyre për gjendjen ekonomike nuk është i pasaktë sepse në veri të Kosovës, sektori publik dominon në strukturën e të punësuarve, pavarësisht nëse punëdhënësi është Republika e Serbisë apo institucionet e Prishtinës. Monopoli i sektorit shtetëror paraqet problem për të rinjtë, në radhë të parë sepse qasja në punë shtetërore nuk është e hapur për të gjithë, por për të marrë një punë shtetërore të duhet një lidhje, domethënë një librezë partie ose një ryshfet, dhe jo njohuritë dhe aftësitë e fituara në fakultet. Sektori publik nuk funksionon sipas parimeve të meritokracisë - dhe për të rinjtë kjo është një çështje jashtëzakonisht delikate, pasi ata i vlerësojnë shumë lartë diplomat që do të marrin. Perceptimi i tyre është se vendet e punës në sektorin publik, janë të rezervuara për të privilegjuarit, jo domosdoshmërisht më të merituarit. Gjendja e tillë në tregun e punës në veri i ka motivuar ata që të largohen, duke shpresuar se potenciali i tyre do të vihet re me kohë në Serbi.

Studentja 1, 21:



Në thelb, të gjithë nxitojnë të kenë një punë në qeveri... dhe gjithmonë është dikush që ka një lidhje, që do të kalojë (në konkurs), që ndoshta do ta paguajë atë punë, sepse te ne vendi i punës, fatkeqësisht, paguhet.



Studentja 2, 21:



Punë jashtë profesionit do të ketë gjithmonë. Por nëse jeni të shkolluar, synimi nuk është ta bësh këtë, por atë për të cilën je shkolluar, që gjithë ai edukim të ketë një qëllim, të shohësh se çfarë keni arritur duke punuar dhe studiuar.



Problemet e identifikuar nga gjenerata e vitit 2020, që kanë të bëjnë me tregun e punës, nuk janë të reja në jetën shoqërore në Kosovë. Si të tilla, ato nuk mund të zgjidhen pa ndryshime sistematike, megjithatë, niveli i optimizimit për një ndryshim të tillë për të rinjtë, është në rënie e sipër. Ata nuk shohin një mënyrë për ta përdorur potencialin e tyre për këtë çështje. Disfata bazohet në bindjen e tyre se komuniteti në Kosovë, nuk ka mirëkuptim për të rinjtë dhe nuk e kupton potencialin e tyre zhvillimor.

Politika

- POLITIKA ËSHTË NJË NGA FAKTORËT MË TË RËNDËSISHËM QË NDIKON NË MIGRATIONIN E GJENERATËS SË VITIT 2020.
- FAKTORËT MË TË RËNDËSISHËM POLITIKË QË NDIKUAN NË VENDIMIN E TYRE JANË PAQËNDRUESHMËRIA POLITIKE, ÇËSHTJET E SIGURISË DHE KONFLIKTI ETNIK

Prandaj, faktorët ekonomikë dhe arsimorë paraqesin arsyet më të rëndësishme për të cilat po intensifikohet migrimi i të rinjve.¹⁵ Në rastin e gjeneratës së vitit 2020, ata përfaqësojnë vetëm një pjesë të problemit. Nëse pranojmë premisën se grupi dominues i faktorëve që ndikojnë në migrimin e të rinjve është i lidhur ngushtë me nivelin e zhvillimit socio-ekonomik të komunitetit vendas, arrijmë te fakti se në Kosovë faktorët e shpjeguar tashmë plotësohen detyrimisht nga faktori politik. Termi politikë, në këtë kontekst, i referohet sistemit dhe praktikave të menaxhimit të shoqërisë, mënyrës së marrjes së vendimeve politike, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve dhe manifestime të tjera shoqërore që janë pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të pushtetit.

Rasti i gjeneratës së vitit 2020 nuk do të ishte i dallueshëm në raport me migrimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe në përgjithësi, nëse vetëm cilësia e arsimit dhe ekonomia do të kristalizoheshin si arsye largimi. Aspekti që e bën të veçantë migrimin e të rinjve serbë nga Kosova është pikërisht çështja e proceseve politike, pra çështja e sigurisë së përgjithshme dhe sigurisë në jetën e përditshme, si dhe atmosfera e përgjithshme e paqëndrueshmëria politike në komunitetin ku ata jetojnë.

Krijohet përshtypja se të rinjtë nuk e kuptojnë plotësisht se si politika ndikon në jetën e tyre të përditshme, por në një kuptim më të gjerë, ata megjithatë njohin se situata në Kosovë është e paqëndrueshme, përdërisa përdorin eufemizma (p.sh. tensione, probleme) për ta përshkruar atë. Normalizimi i pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë, proces nëpër të cilin kaluan të rinjtë duke u rritur në Kosovë, është i zakonshëm për shoqëritë pas konfliktit.¹⁶ Në këtë rast, rezultoi që të rinjtë t'i kuptojnë çështjet si siguria në një mënyrë specifike,

nëse e kuptojnë sigurinë si sigurinë e ushtrimit të lirisë dhe të drejtave. Një shembull plastik i kësaj idiosinkrazie në të menduarit e tyre, është mënyra se si të rinjtë nga Mitrovica e Veriut e kuptojnë lirinë e lëvizjes: ata në mënyrë paradoksale besojnë se kanë liri të plotë të lëvizjes, në qytetin e tyre, në komunitetin e tyre, pavarësisht se nuk lëvizin kurrë përtej urës që e ndan veriun dhe jugun e Kosovës.

Specifikat në të menduarit e të rinjve për politikë nuk mbarojnë me kaq. Rezultatet e normalizimit të paqëndrueshmërisë manifestohen edhe në mënyrën se si të rinjtë i perceptojnë ngjarjet rreth tyre. Vetëm ato ngjarje të ndërlikuara politike, si për shembull ngjarja me barrikada nga viti 2022, ata e shohin si rrezik të drejtpërdrejt, ndërsa situata para dhe pas kësaj vlerësohet si normale. Ky është pjesërisht efekti i rolit mbrojtës prindëror, por edhe i desensibilizimit të përgjithshëm shoqëror.

Një tjetër palogjikshmëri në qëndrimet e gjeneratës së vitit 2020, shumë e rëndësishme për këtë çështje, është perceptimi i tyre personal për sigurinë, në kundërshtim me sigurinë e të tjerëve. Ndërsa, nga njëra anë, shprehimisht pohojnë se ndihen të sigurt gjithmonë dhe kudo¹⁷, pranojnë se të tjerët mund të ndihen të kërcënuar, veçanërisht vajzat. Qëndrimet e tilla paradoksale mund t'i atribuohen emocioneve dhe jo kuptimit racional të pozicionit të tyre.

Së fundi, vetë çështja e sigurisë nuk mund të kuptohet plotësisht pa dimensionin e gjinisë. Përkatesisht, ngacmimet dhe sulmet me motive etnike paraqesin trend negativ në Kosovë.¹⁸ Në vetvete, ato paraqesin një problem të vështirë për t'u tejkaluar dhe kur atyre u shtohet dimensionin gjinor, kur ngacmimi merr konotacion seksual, arrijmë në pikën ku vajzat e reja në Kosovë ndihen dyfish

¹⁵(PDF) Emigracioni potencial mladih u Srbiji / Emigration Potential of Youth in Serbia (researchgate.net)

¹⁶ <https://hrcak.srce.hr/file/149521>

¹⁷ Ky është qëndrimi i bashkëbiseduesve meshkuj, të cilët ku u pyeten drejtpërdrejt se a ndjehen të sigurt në Kosovë, sipas rregullit përgjigjeshin pozitivisht, megjithatë gjatë bisedës së mëtejshme vëreheshin shumë nuanca lidhur me këtë çështje.

¹⁸ <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/hovosti-od-marta-prosle-godine-zabelezeno-214-napada-na-srbe-na-kosovu-20-8-2022>

<https://www.kim.gov.rs/lat/incidenti-kim.php>

të kërcënuara: sepse janë serbe dhe sepse janë femra. Në një atmosferë të tillë edhe vajzat e reja motivohen më tepër të largohen.

Studentja 1, 21:

Në Mitrovicë kishte shumë... merak se a isha e sigurt... prindërit nuk më lanë të shkoja vetëm në pyll, vetëm në kodër. Kishin frikë... ka pasur shembuj të shumtë ku shqiptarët kanë ardhur, kanë gjuajtur fjale te vajzat, nuk është gjë e vogël, është ngacmim seksual... Dhe unë kam qenë në një farë mënyre viktimë e kësaj, fjalë për fjalë në shëtitoren e Mitrovicës, në pjesën veriore. Ata thonë se është e sigurt, por në fund të fundit nuk është, nuk mendoj se shqiptarët nuk na respektojnë. Ne trajtohemi gjithmonë në mënyrë të pabarabartë!

Dimensioni politik i shkaqeve të largimit të të rinjve, e vendos migrimin e të rinjve nga veriu i Kosovës në një këndvështrim tjetër krahasuar me flukset standarde të migrimit të të rinjve. Të rinjtë nga gjenerata e vitit 2020 dëshmuar se, përtej arsimimit dhe ekonomisë, ndër faktorët më të rëndësishëm, ekziston edhe një grup arsyesh dhe motivesh shumë më komplekse për largimin nga Kosova. U tregua se rritja në një mjedis ku paqëndrueshmëria politike, nepotizmi dhe korrupsioni normalizohen, një sistem vlerash i adoptuar në familje, brenda të cilit vlerësohen njohuritë dhe arritjet, është një motiv i vlefshëm për t'u larguar. Përveç kësaj, ky rast na tregon se si e sheh politikën një brez i të rinjve. Ata konsiderojnë se zgjidhja e problemeve thelbësore në shoqërinë kosovare mund të arrihet në mënyrë më të sukseshme nëpërmjet ndryshimeve politike. Paradoksalisht, politika është një fjalë e ndyrë për ta, dhe politika praktike ka një konotacion dukshëm negativ dhe është e ndërlidhur me praktika joetike. Hulumtimi për pluralizmin politik në veri të Kosovës, i kryer në vitin 2022, konfirmon se komuniteti i gjerë e ndan këtë mendim: politika është e lidhur me manipulime, interesa dhe keqpërdorime.¹⁹ Qëndrimet e tilla të të rinjve janë pasojë e degradimit afatgjatë të jetës politike, në të cilën duket se elitat politike nuk ndërrojnë pushtetin, por vetëm qarkullojnë, me të njëjtat ide dhe modele sjelljeje politike.

¹⁹ https://ngocasa.org/wp-content/uploads/2022/04/Gradjani-u-politici_SRB.pdf

Familja dhe miqtë

- MBËSHTETJA NGA FAMILJA ËSHTË KUSHITI MË I RËNDËSISHËM PËR MIGRIMIN E TË RINJVE
- FAMILJA SIGURON MBËSHTETJE SEPSE KONSIDERON SE ATMOSFERA POLITIKE, EKONOMIKE DHE SHOQËRORE NË KOSOVË ËSHTË NEGATIVE DHE DEMO-TIVUESE PËR TË RINJTË.
- MBËSHTETJA NGA MIQTË KA TENDENCA TË SHKAKTOJË NJË EFEKT TË TOPIT TË BORËS NË MODELET E MIGRIMIT TË TË RINJTVE

Të rinjtë e gjeneratës së vitit 2020 pajtohen se faktori kryesor që ndikon në largimin e tyre është kërkimi i një arsimimi cilësor, por ngjashmëria në të menduarit e tyre shihet edhe kur bëhet fjalë për rolin e familjes. Inkurajimi që morën nga familja për ta ishte një moment kyç në marrjen e vendimit për t'u larguar. Mbështetjen e familjes duhet ta shikojmë si kusht të domosdoshëm për largimin e tyre: të rinjtë mbështeten te prindërit e tyre, si materialisht, ashtu edhe emocionalisht, kështu që mungesa e mbështetjes prindërore do të nënkuptonte edhe fundin e planeve të tyre për t'u larguar nga Kosova. Të rinjtë janë të përqendruar në arsimim e tyre, gjë që nënkupton se prindërit ua sigurojnë atyre kushte materiale në të cilat ata mund t'i përkushtohen pa pengesa detyrave të tyre studentore.

Familja, si një bashkësi bio-psiko-sociale, ka një sërë rolesh, të cilat nuk shterren vetëm nëpërmjet sigurimit të burimeve materiale dhe emocionale. Kështu krijohet përshtypja se në rastin e të rinjve nga Kosova theksohet fuqishëm edhe roli mbrojtës: prindërit përpiqen në çdo mënyrë t'i mbrojnë fëmijët e tyre nga realiteti jetësor në Kosovë. Nëse të rinjtë nuk i kuptojnë, ose nuk mund t'i artikulojnë pikëpamjet e tyre për këtë çështje, prindërit mundën dhe arsyet e tyre për mbështetjen e fëmijëve të tyre për t'u larguar nga Kosova, i klasifikojnë si faktorë ekonomikë, politikë dhe shoqërorë.

Prindërit e dinë se nepotizmi dhe korrupsioni janë fenomenet kryesore që paraqesin pengesa për jetën normale të të rinjve. Ata krijojnë një atmosferë negative socio-ekonomike në të cilën potenciali i të rinjve nuk mund të përdoret në mënyrën e

duhur. As prindërit dhe as të rinjtë nuk besojnë se përfaqësuesit politikë të serbëve në Kosovë, përkatësisht përfaqësuesit e Listës Serbe, kujdesen për interesat e tyre dhe kjo duhet të jetë prioritet i tyre, sepse popullata e re është një burim i rëndësishëm për mbijetesën dhe zhvillimin e komunitetit të serbëve në Kosovë.

Prindi 1:

Pushteti ka përgjegjësi për gjithçka, të paktën kështu mendoj unë. Gjithçka fillon prej tyre. Të gjithë e dimë se çfarë është e mirë dhe çfarë jo, është vetëm çështje vullneti. Nëse dikush dëshiron ta bëjë apo jo apo dikujt nuk i intereson... Është sikur po bën të kundërtën. Unë punoj në kuadër të Qendrës Studentore dhe vërtet mund ta ndjeni se ajo popullsi... ka shumë më pak studentë në qytet, është vërtet e dukshme në punën tonë.

Përderisa të rinjtë kanë një mënyrë më paradoksale të të kuptuarit të sigurisë në veri të Kosovës, për të cilën u diskutua në kapitullin e mëparshëm, prindërit shprehimisht e vënë në plan të parë këtë problem. Prindërit e kuptojnë sigurinë si siguri fizike, siguri nga krimi dhe siguri nga konfliktet e mundshme etnike. As Serbia ku shkojnë të rinjtë nuk është pa këto probleme,²⁰ megjithatë prindërit janë të kënaqur që nëse ndodh ndonjë problem në Beograd apo Novi Sad, nuk do të jetë i motivuar etnikisht, gjë që paraqet lehtësim për ta. Qëndrime të tilla flasin për një distancë të thellë etnike dhe shoqërore ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, ku nuk janë plotësuar parakushtet themelore për funksionimin e një shoqërie multietnike dhe multikulturore.

²⁰ <https://rm.coe.int/16806ef3a2>

<https://www.danas.rs/vesti/drustvo/srbija-pala-na-93-mesto-na-rang-listi-reportera-bez-granica/>

Prindi 2:

Ndihem më i sigurt, në një kuptim... Por jo në kuptimin që janë të shkëputur nga krimi, por thjesht nuk ekziston problemi i tillë ndëretnik, nuk ka komponentë të tillë...

Pasoja vendimtare e rolit mbrojtës prindëror mund të shihet nëpërmjet faktin se ata i mbështesin të rinjtë për largimin nga Kosova, madje edhe i inkurajojnë që të mos kthehen pas përfundimit të studimeve. Korrupsioni, nepotizmi, çështjet e sigurisë janë shkaqet kryesore për këtë fakt, ndërsa për të qëndruar, vetëm një arsye është kristalizuar, ruajtja e marrëdhënieve të ngushta me familjen. Si rregull, dhe jo vetëm në Kosovë, familja konsiderohet vlerë supreme, gjersa migrimi i të rinjve ndikon negativisht në të. Ato çojnë në ndarjen e brezave në familje, e cila është një risi me të cilën duhet të përshtaten të gjithë anëtarët e familjes, ndërsa të rinjve u mbetet ta rishqyrtojnë kuptimin e lidhjeve familjare dhe të përkatësisë. Të rinjtë nga gjenerata e vitit 2020 janë produkt i mjedisit të tyre: ata pranojnë vlerat tradicionale dhe planifikojnë familjet e tyre, që për ta paraqet një arsye shtesë për të qëndruar në Serbi, pasi mund të planifikojnë të ardhmen e tyre atje.

Prindi 3:

(Në lidhje me kthimin e fëmijës së tij pas përfundimit të studimeve):

Jo, ai e di se nuk ka asgjë për t'u kthyer këtu. Vetëm nëse nuk ia del, atëherë le të vijë këtu dhe do t'i blej ndonjë biznes ku do të orientohej, të bënte diçka. Vetëm nëse do të ketë sukses në jetë, e nuk e besoj. Në kokën e tij Kosova dhe Metohia nuk ekziston më.

Lidhjet me miqtë janë po aq të forta sa lidhjet familjare. Gjenerata e vitit 2020 e sheh mbështetjen e miqve në procesin e largimit nga Kosova, përshtatjen në një mjedis të ri, si një burim të rëndësishëm. Ata filluan studimet gjatë pandemisë Covid-19 dhe në një periudhë të tillë krize ishte jashtëzakonisht e dobishme që edhe miqtë e tyre studionin në të njëjtin vend.

Në çdo gjeneratë ekziston një numër i caktuar studentësh që vendosin të studiojnë jashtë Kosovës. Migrimi i motivuar nga arsimimi nuk është as i ri dhe as i rrallë. Megjithatë, gjenerata e vitit 2020 tregoi se ekziston një dukuri specifike në flukset migracionit të të rinjve, e cilësuar si efekti i topave të borës. Efekti i topave borës shpjegohet nëpërmjet dukurisë ku, të rinjtë që tashmë kanë shkuar për të studiuar, i motivojnë miqtë e tyre që të ndjekin të njëjtin shembull. Kjo e tregon dukurinë se shkuarja në qendrat arsimore dhe ekonomike jashtë Kosovës është bërë normë shoqërore dhe opsioni i parë në planifikimin e së ardhmes tek popullata e re. Ata ndihmojnë njëri-tjetrin duke shkëmbyer informacione të nevojshme për studime, gjë që në radhë të parë ua lehtëson përzgjedhjen e një programi studimi dhe më pas edhe gjetjen e rrugës në përditshmërinë e re. Mbështetja e moshatarëve ua lehtëson tranzicionin nga Mitrovica e Veriut në Beograd ose Novi Sad dhe ka potencial të bëhet trend. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që adoleshentët²¹ ta plotësojnë nevojën e tyre për përkatësi dhe këtë e bëjnë përmes grupeve të bashkëmoshatarëve. Ata janë konformistë në natyrë, kështu që mund të konkludohet se të rinjtë janë të ndjeshëm ndaj zhvillimit të qëndrimeve dhe opinionëve të ngjashme dhe marrin e vendime të ngjashme në një grup. Meqenëse numri i të rinjve që largohen nga Kosova rritet çdo vit, ky efekt ka potencial të bëhet trend në lëvizjet migruese të të rinjve, gjë që do të ketë një efekt shkatërrues në potencialin njerëzor të komunitetit serb në Kosovë.

²¹ Rreth potencialeve konformiste të të rinjve: <https://core.ac.uk/download/pdf/197674011.pdf>

Përfundimi

Rasti i gjeneratës së vitit 2020 nuk është krejtësisht i ndryshëm nga lëvizjet migruese të të rinjve në shoqëritë pas tranzicionit. Të rinjtë, të motivuar nga arsimimi më cilësorë dhe shanset më të mira në tregun e punës, largohen nga komunitetet e tyre pas përfundimit të shkollës së mesme, me idenë për të mos u kthyer. Megjithatë, rasti i gjeneratës së analizuar ka specifikat e veta në lidhje me trendet ekzistuese: ata ishin të motivuar për t'u larguar edhe për shkak të paqëndrueshmërisë politike, ndjenjës së pasigurisë dhe mundësisë së shpërthimit të një konflikti etnik. Atmosfera politike në të cilën ndodh shpërngulja e të rinjve nga Kosova është një arsye e mjaftueshme për të tërhequr vëmendjen ndaj kësaj dukurie dhe për ta analizuar atë në thellësi, në mënyrë që mbi këtë bazë të formohen zgjidhjet e mundshme për këtë problem. Ky hulumtim mund të jetë vetëm një hap në këtë drejtim.

Studimi rasti si metodë nuk e ofron mundësinë e përgjithësimin dhe as nuk mund të përdoret si bazë për të ofruar ndonjë parashikim të qëllimshëm të tendencave të migrimit të të rinjve nga Kosova, por mund të vërehen rregullitë në këto lëvizje dhe mund të hidhet dritë në mekanizmat që funksionojnë brenda tyre.

Ky studim bëri të mundur ndriçimin e dy çështjeve të rëndësishme:

1. Të përcaktohet ndikimi i faktorit politik, si faktor që është karakteristik për migrimin e të rinjve nga Kosova, e jo për flukset e zakonshme migruese të të rinjve.
2. Të ndriçohet efekti i topave të borës, i cili nëse kthehet në trend mund të ketë ndikim shkatërrues në komunitetin serb në Kosovë duke përshpejtuar dhe komplikuar flukset migruese të të rinjve.

Nga kjo rrjedh një pyetje e rëndësishme:

Pse është kjo gjë problematike?

Brezi i vitit 2020 na tregoi se migrimi i të rinjve, i cili në gjeneratat e mëparshme u shfaq në formën e largimeve sporadike në kuadër të çdo brezi, ka potencial të bëhet trend tani. Efekti i topit të borës i njohur në flukset migruese të gjeneratës të vitit 2020 e tregon këtë.

Nga ana tjetër, migrimet e të rinjve ndikojnë në mënyrë cilësore dhe sasiore në veri të Kosovës, si komunitet nga i cili ata largohen. Duke supozuar se të parët largohen studentët më të zgjuar dhe më të talentuar, të cilët e përdorin potencialin e tyre për të përmirësuar komunitetin në të cilin kanë shkuar, veriu i Kosovës humbet kështu potencialin që mund të përdoret për të përmirësuar jetën në Kosovë. Veriu i Kosovës ka nevojë për njerëz të arsimuar dhe të zgjuar për të mbijetuar dhe për zhvillimin e tij potencial. Këta njerëz përbëjnë një resurs për komunitetin, pa të cilin resurs do të mbetet për shkak të migrimit që po ndodh në këtë kohë.

Në kuptimin sasior, largimi i përhershëm i të rinjve e zvogëlon potencialin e komunitetit amë, pra veriu të Kosovës, për riprodhim: popullsia plaket dhe në mënyrë të natyrshme shkon drejt shkallëve gjithnjë e më të larta të shpopullimit. Në 10 vjetët e fundit, përafërsisht 40 mijë serbë janë larguar nga Kosova dhe ky largim në shumë mënyra i prek edhe ata që mbeten. Ndërsa të rinjtë vazhdojnë të largohen në numër gjithnjë e më të madh, dhe sa më e vjetër të jetë popullsia, aq më pak do të investohet në komunitet. Rrjedhimisht, cilësia e jetesës do të bjerë, gjë që do të ndikojë negativisht në jetën e atyre që mbeten, përfshirë këtu edhe ata të rinjtë që do të mbesin në komunitetin amë. Kjo më tutje do të çojë në faktin se të rinjtë, nën presionin e situatës, do të vazhdojnë të largohen nga Kosova, pasi që aty nuk do të shohin më perspektivë, kështu që vijmë në një rreth vicioz migrimesh, të cilat në një periudhë afatgjatë mund të rrezikojnë mbijetesën e serbëve në Kosovë. Tendencat tilla migrimi paraqesin një kërcënim për mbijetesën e komunitetit serb, i cili ka mbetur pa potencial të vlefshëm njerëzor dhe nuk ka aftësi natyrore për t'u ripërtërirë.

Shembulli i gjeneratës së vitit 2020 tregon se në çfarë mënyrash veriu i Kosovës po e humb burimin më të vlefshëm - të rinjtë me potencial për të përmirësuar ndjeshëm komunitetin e tyre. Duke identifikuar arsyet e largimit të tyre, marrim udhëzime dhe sinjale se çfarë mund të bëjë shoqëria për ta bërë jetën më cilësore për të rinjtë në Kosovë. Megjithatë, gjenerata e vitit 2020 e planifikon të ardhmen e saj në Serbi apo edhe jashtë saj, dhe nuk tregon asnjë motiv apo besim për mundësinë që situata në Kosovë mund të ndryshojë për të mirë dhe ta konsiderojë atë një vend të dëshiruar për të jetuar dhe për të planifikuar një familje. Kështu, rasti i gjeneratës së vitit 2020 bëhet rast i humbjes së pariparueshme të potencialit njerëzor në Kosovë.

Graffiti në murin e një shkolle në Mitrovicën e Veriut, 2022



